



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHAK	8591/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1213/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1213/2022 të datës 19.12.2022 të parashtruar nga ankuesia të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat

kundër Vendimit me Nr. Ref:642/2022 të datës 06.12.2022 dhe numër protokolli 5302 të datës 09.12.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1213/2022 të datës 19.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja , më datë 19.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8190/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. Ref: 642/2022 të datës 06.12.2022 dhe numër protokolli 5302 të datës 09.12.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Ministria Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli me datën 28.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, , ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 8190/2022 të datës 19.12.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Ref: 021/13 të datës 25.01.2013; Vendimin me Nr.Ref:12/2017 të datës 19.01.2017; Vendimin me Nr.38/2018 të datës 18.01.2018; Notën Verbale me numër Ref: ZDP/114/2018 e datës 09.07.2018; Vendimin me Nr. 573/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.Ref: 04/2020 i datës 27.03.2020;Vendimin me Nr. 198/2020 i datës 13.05.2020; Vendimin me Nr.259/2020 i datës 30.06.2020; Vendimin me Nr. Ref: 335/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.847 i datës 16.10.2018; Vendimin me Nr.Ref: 1039/2020 i datës 18.12.2020; Vendimin me Nr.Ref:176/2020 i datës 25.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:642/2022 të datës 06.12.2022 me numër protokolli 5302 të datës 09.12.2022; Autorizim i datës 09.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 8315/2022 e datës 22.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 8502/2022 e datës 28.12.2022; Konkursin për drejtues dhe nëpunës tjerë të Misionit Diplomatik i datës 22.07.2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1213/2022 të datës 13.09.2022 të parashtruar nga ankuesja , sepse:

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur së Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin Nr.140/11 të datës 21.07.2011 ka miratuar shpalljen e Konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 ka shpall Konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja. Me tej, nga shkresat e lëndës rezultojnë së lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankueses në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar së ankuesja bazuar në Vendimin Nr.Ref.021/13 të datës 25.01.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke i'u caktuar grada diplomatike "Sekretare e Parë", dhe njëkohësisht e njëjta caktohet të shërbej si Sekretare e Parë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Austri. Tutje, bazuar në provat e lëndës rezultojnë së ankuesja me Vendimin Nr.Ref:12/2017 të datës 19.01.2017 të Ministrit të MPJ-së është transferuar paralelisht në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Hagë/Holandë. Me Vendimin me Nr.38/2018 të datës 18.01.2018 të Ministrit të Punëve të Jashtme , ankues i vazhdohet mandati i shërbimit në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Hagë/Holandë deri më datë 31.08.2018, ndërsa me Vendimin me Nr.573/2018 të datës 13.07.2018 i është vazhduar serish mandati i shërbimit në këtë mision diplomatik deri më datë 24.01.2021. Me Vendimin me Nr. Ref: 104/2020 të datës 27.03.2020 të Ministrisë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ankuesja është tërhequr nga misioni më datë 30.06.2020, ndërsa sipas Vendimit me Nr.198/2020 të datës 13.05.2020 dhe Vendimin me Nr.259/2020 të datës 30.06.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është shtyrë ekzekutimit i Vendimit me Nr. Ref:104/2020.

Me tej nga provat e lëndës rrjedhe së me Vendimin Nr.Ref:35/2020 të datës 10.07.2020, Vendimin me Nr.Ref:1039/2020 të datës 18.12.2020 dhe Vendimin me Nr.Ref:176/2022 të datës 25.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankueses i është vazhduar mandati në mision diplomatik Sekretare e Parë në Ambasadën e Kosovës në Hagë deri më datë 31.12.2022.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 06.12.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref:642/2022 përmes të cilit ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr.Ref: 021/13 të datës 25.01.2012 për emërimin e ankueses si anëtare e Shërbimit të Jashtme të Republikës së Kosovës, mbi bazën së ankuesja është emëruar në shërbim të jashtëm në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Ref: 642/2022 të datës 06.12.2022 dhe numër protokolli 5302 të datës 09.12.2022 të Ministres së MPJD-së, pretendon së vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkeljeve të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkeljeve të ligjit material.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet se: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarave politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesja ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se e njëjta ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses*

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të



Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:


Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1213/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses .
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së